



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 62, datë 1.2.2012

PËR

**MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ÇMIMIT
TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit të Çmimit të Barnave, si njësi e përhershme, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Komisioni i Çmimit të Barnave kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe ka këtë përbërje:
 - a) Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, një anëtar;
 - b) Ministria e Financave dy anëtarë;
 - c) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës një anëtar;
 - ç) Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dy anëtarë.
3. Sekretar i komisionit është një specialist në Drejtorinë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë. Titullarët e institucioneve të përmendura në këtë pikë caktojnë në detyrën e anëtarit të komisionit, punonjës që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij komisioni.

4. Mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar, përfaqësítë farmaceutike të huaja në Shqipëri, brenda datës 30 shtator të çdo viti, deklarojnë me shkresë, në zarf të mbyllur, pranë Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, çmimet “CIF” në euro ose dollarë, për barnat e importit, dhe çmimet “EXW” (ex-works) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend.
5. Drejtoria Farmaceutike njofton, zyrtarisht, mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit, përfaqësítë farmaceutike të huaja në Shqipëri, për dorëzimin e informacionit për çmimet, jo më vonë se dy muaj para datës 30 shtator.
6. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 5 tetor të çdo viti, mblidhet me njoftim të kryetarit për hapjen e zarfeve të çmimeve të deklaruara, të cilat siglohen nga anëtarët e pranishëm të komisionit.
7. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 5 nëntor, mblidhet për të shqyrtauar informacionin e përpunuar nga specialistët e çmimeve të barnave në Drejtorinë Farmaceutike, për barnat e listës që rimbursohen nga ISKSH-ja. Në këtë mbledhje, komisioni miraton çmimet që do të shpallen zyrtarisht.
8. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 15 dhjetor, mblidhet për të shqyrtauar informacionin e përpunuar nga specialistët e çmimeve të barnave në Drejtorinë Farmaceutike, për barnat jashtë listës së rimbursuar nga ISKSH-ja. Në këtë mbledhje, komisioni miraton çmimet që do të shpallen zyrtarisht.
9. Mbledhjet e Komisionit të Çmimit të Barnave janë të vlefshme kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Miratimi i çmimeve të barnave bëhet me votim të hapur dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se ka barazim votash, vota e kryetarit është vendimtare.
10. Komisioni i Çmimit të Barnave, kur është e nevojshme, mblidhet me njoftim të kryetarit, për të miratuar çmimet e deklaruara për barnat që regjistrohen gjatë vitit kalendarik. Në këto raste, miratimi i çmimit të barnave bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas depozitimit të deklarimit të tyre, pranë Drejtorisë Farmaceutike.

11. Çmimet “CIF”, të deklaruara në Shqipëri, do të krahasohen me çmimet e “CIF” të shteteve referente: Itali, Greqi dhe Maqedoni. Kur mungon informacioni për çmimet “CIF” nga shtetet referente, krahasimi do të bëhet me çmimet e shitjes me pakicë të barit. Çmimet e shitjes me pakicë në Shqipëri do të krahasohen me çmimet e shitjes me pakicë të barit në shtetet referente.
12. “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë çmimi më i ulët që aplikohet ndër tri shtetet referente.
13. Në rast se bari nuk tregtohet në asnjërin nga shtetet referente, mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, përfaqësitet farmaceutike të huaja në Shqipëri, do të vetëdeklarojnë tri çmime krahasuese “CIF” të barit nga vende të tjera ku tregtohet bari, sipas shtetit gjeografikisht më të afërt me Shqipërinë.
14. Në këtë rast “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë mesatarja e dy çmimeve më të ulëta që aplikohen nga tri shtetet referente.
15. Informacioni për krahasimin e çmimeve të barnave do të merret nga botimet zyrtare, të publikuara nga institucionet shtetërore të vendit përkatës. Kur nuk arrihet të sigurohet informacion nga këto burime, ministri i Shëndetësisë bashkë me ministrin e Financave miratojnë me urdhër të përbashkët burime të tjera informacioni.
16. Komisioni i Çmimit të Barnave miraton çmimet, që nuk e kalojnë “Çmimin e referencës për Shqipërinë”. Kur çmimi i barnave, që janë alternativë e vetme, del më i lartë se “Çmimi i referencës për Shqipërinë” bëhet negociim për uljen e çmimit.
17. Nga ky rregull bëjnë përjashtim çmimet e miratuara për vitin 2012, për të cilat, kur janë më të larta se “Çmimi i referencës për Shqipërinë”, negociohet për uljen e çmimit.
18. Barnat, për të cilat nuk është dekluarar çmim ose nuk janë regjistruar deri më 30 nëntor të vitit aktual, humbasin të drejtën për t'u futur në listën e barnave të rimbursuara për vitin pasardhës. Bëhet përjashtim vetëm për barnat që janë alternativa të vetme në treg dhe barnat që janë në proces riregjistrimi.
19. Drejtoria Farmaceutike, brenda datës 25 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë të listës së përgjithshme me

çmimet “CIF”, përvëç barnave që janë në proces negociimi. Kjo listë u njoftohet zyrtarisht Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

20. Kundër vendimit të Komisionit të Çmimit të Barnave, subjektet kanë të drejtën e ankimit te ministri i Shëndetësisë, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit. Kundër vendimit përfundimtar bëhet ankim në gjykatë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.
21. Anëtarët e komisionit, për çdo mbledhje, shpërblehen me 5 000 (pesë mijë) lekë, nga fondet buxhetore, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.
22. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Financave miratojnë rregulloren për metodologjinë dhe mënyrën e administrimit të çmimeve të deklaruara, e cila do të ndiqet për caktimin e çmimeve të barnave.
23. Vendimi nr.504, datë 7.7.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave”, shfuqizohet.
24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA

MINISTRI I SHËNDETËSISË

PETRIT VASILI

MINISTRU FINANCAVE

RIDVAN BODE